

DPK/DMA

02

03-4407/12

07.12.2012

GJL. Nr. 1265/2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e Sek. juridike Nexhmije Abazxhik, duke vendosur sipas ankesës së Agjencisë Kundër Korrupsionit të Republikës së Kosovës, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 18216/2012 të dt. 22.10.2012, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 konform të nenit 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 09.11.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa e paraqitur si e pabazuar

VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 18216/2012 të dt. 22.10.2012, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Nr. regj. 18216/2012 të dt. 22.10.2012, të pandehurin Avdullah Klinaku nga Vushtrria. e ka shpallë përgjegjëse sepse: si Këshilltar i Ministrisë së Shëndetësisë, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e paraparë për vitin 2011, edhe pse ka qenë e njoftuar me kohë për këtë obligim ligjor, është vonuar deri më dt. 05.04.2012, kur e ka bërë deklarin e pasurisë, me ç,veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 5 dhe 6 par. 1 dhe 2 neni 8 par. 1,2 të sanksionuar me nenin 17 par. 1.1. të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, me nr. 04/L-050, dhe i është shqiptuar masa e Qortimit, konform të nenit 10 të LK.

Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15 (pesëmbëdhjetë) Euro.

Kundër këtij aktvendimi Agjencioni Kundër Korrupsionit të Republikës së Kosovës, ka paraqitur ankesë, për shkak të: Vendimit mbi dënimin, me arsyetim se Gjykata duke u bazuar në nenin 10 të LK-së, i ka shqiptuar të pandehurit Qortim, ku si arsye kryesore dhe si rrethanë lehtësuese gjyqtari ka marr faktin se i pandehuri e ka pranuar se është vonuar nga se ka qenë në udhëtim zyrtar dhe se koha e vonës nuk ka qenë shumë e gjatë. Se Gjykata e shkallës së parë gjatë zhvillimit të procedurës i ka lëshuar faktet relevante dhe rrethanat tjera të cilat kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në kryerjen e veprës kundërvajtëse. Nga se kjo vepër përkon me një përgjegjësi të lartë nga i pandehuri siç është deklarimi i pasurisë nga zyrtarët e lartë publik, se këtë dënim e ka zbutur pa arsye të justifikueshme.

Kolegji i kësaj gjykate duke i vlerësuar thëniet në ankesën, aktvendimin e goditur dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur është e pabazuar, ashtu që aktvendimi i goditur vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

2.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse, në bazë të deklaratës së dhënë të pandehurit Avdullah Klinaku, në seancën e shqyrtimit kryesor pranë Gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt. 10.10.2012, i cili në mbrojtjen e vet e ka pranuar kundërvajtjen e cila i vihet në barrë me arsyetim se është vonuar 2-3 ditë për shkak se ka qenë në udhëtim zyrtar, por tani e ka deklaruar pasurinë dhe si dëshmi për këtë gjykatës i ka ofruar në shikim provën-vërtetimin e dt. 05.04.2012, të cilin e ka lënë në shkresat e lëndës e i cili vërtetë dëshmon se i pandehuri e ka deklaruar pasurinë me 5 ditë vonesë; si dhe nga shkresat tjera të lëndës, pa dyshim se e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer vepër të përshkruar si në dispozitiv të aktvendimit të goditur, për të cilën mbanë përgjegjësi kundërvajtëse.

Gjersa sa iu përket pretendimeve të parashtruesit të ankesës, Kolegji konsideron se ato janë të pabaza për shkak se eksitojnë rrethanat të cilat e zvogëlojnë përgjegjësinë për të pandehurin, gjegjësisht nga shkresat e lëndës konstatohet se i pandehuri e ka deklaruar pasurinë me vonesë prej 5 ditësh, gjegjësisht më dt. 05.04.2012, kurse Agjencioni Kundër Korrupsionit e ka parashtruar kërkesën për hapjen e procedurës kundërvajtëse më dt. 21.05.2012. Andaj duke marr parasysh se i pandehuri e ka përmbushur obligimin e tij ligjor, se për herë të parë ka kryer vepër kundërvajtëse, se pasojat e veprës së kryer nga i pandehuri ishin minimale, se i pandehuri e ka pranuar përgjegjësinë kundërvajtëse për shkak të vonesës për dorëzimin e aplikacionit, dhe faktin se është arritur qëllimi-deklarimi i pasurisë pranë Agjencionit.

Nga të cekurat më lartë Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vlerësuar peshën dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra kundërvajtëse, duke e ndëshkuar të pandehurin me masën Qortim, andaj nuk ka bazë për anulimin apo ndryshimin e aktvendimit të goditur siç ka propozuar parashtruesi i ankesës.

Kolegji vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, gjatë zbatimit të procedurës kundërvajtëse, nuk ka bërë shkelje të dispozitave kundërvajtëse, përkatësisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale, kurse masa e Qortimit konform të nenit 10 të LK. të shqiptuar ndaj të pandehurit Avdulalh Klinaku, konsiderohet se është caktuar dhe përcaktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, peshës së veprës të kryer si dhe rrethanave në të cilën është kryer vepra, andaj edhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për ndryshimin apo abrogimin e aktvendimit të goditur.

Andaj konform të nenit 220 të LMK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

GJL. Nr.1265/2012 të dt. 09.11.2012.

SEK. JURIDIKE
Nexhmije Abazxhik



KRYETARJA E KOLEGJIT,

Mejreme Zekaj

(Handwritten signature)